

V E N D I M
Nr. 572, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE
NË BASHKINË E LIBRAZHBIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Librazhdit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Librazhdit.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2100 m², tokë, arë, në shumën e përgjithshme prej 1 890 000 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Librazhdit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjetë e tetë mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Paga e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Librazhdit.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA LIBRAZHD**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Enver Bilal Mana	2100	900	1.890.000